



ARGUMENTUM

news opinion analysis



Këndvështrime

**Turneu evropian i
Xi Jinping, një urë për
Paqe dhe Prosperitet Global**

Në sfondin e një situatë të trazuar ndërkombëtare, me një ekonomi botërore të pasigurtë dhe sfidat globale në rritje, vjen turneu evropian i Presidentit të Kinës Xi Jinping.

Konkretisht trajektorja Francë-Serbi-Hungari e turneut të presidentit kinez Xi Jinping, shihet si një hap tjetër drejt rindërtimit të besimit me kontinentin, me fokus bashkëpunimin pragmatik.

Lidhjet midis Kinës dhe Bashkimit Evropian janë të ndryshme dhe kanë ndikim të madh në politikën globale, tregtinë, dhe shumë aspekte të tjera të marrëdhënieve ndërkombëtare, ndaj dhe ky tur është një mundësi për të dyja palët për të thelluar mirëkuptimin e ndërsjellë dhe për të zgjeruar bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh.

Pikërisht me fokus zhvillimin e marrëdhënieve ak-

tuale në aspektin gjeopolitik, ekonomik Kinë-Europë, ARGUMENTUM.al vjen me një Edicion Special.

Një vështrim analitik brenda turneut evropian të Xi Jinping nga pesë analistë shqiptarë, të cilët sjellin këndvështrimin e tyre mbi rëndësinë e marrëdhënieve Kinë-Europë në përgjithësi dhe për turneun evropian të Presidentit kinez Xi Jinping në veçanti.

Një perspektivë globale mbi marrëdhëniet dypalëshe, shumëpalëshe, potencialet e bashkëpunimit dhe sfidat globale.

Në këtë kohë mundësish dhe sfidash partneriteti Kinë- Europë, tregon domosdoshmërinë për të punuar së bashku, për ta bërë botën tonë një vend më të sigurt për të jetuar.

© 2024 Argumentum..

Përmbajtja



Dr. Jorgji KOTE

03 Vizitë e mirëpritur e Presidentit Xi Jinping në Europë!

A welcomed Chinese presidential visit in Europe! 28



Dr. Marsela MUSABELLIU

07 Diplomacia e kreut të shtetit në akison: Xi, Macron dhe dinamikat e Euroazisë

Head of State Diplomacy in action: Xi, Macron and the dynamics of Eurasia 32

23 Prezenca e Kinës në Evropën Qendrore dhe Lindore në kontekstin e vizitës së Xi Jinping

China's presence in Central and Eastern Europe in the context of Xi Jinping's visit 45



Marjana DODA

11 Paris, Beograd, Budapest: Një vështrim brenda turneut evropian të Xi Jinping

Paris, Belgrade, Budapest: An overview of Xi Jinping's European tour 35



Albert VATAJ

15 Konfucizmi "axhenda" filozofike e vizitës së Presidentit kinez, Xi Jinping në Europë

Confucianism, the philosophical "agenda" of Chinese President Xi Jinping's visit to Europe 38



Etleva XHAJANKA

19 Vizita e liderit kinez Xi Jinping dhe nevoja për të nxitur marrëdhëniet tregtare me kontinentin evropian dhe Ballkanin Perëndimor

The visit of the Chinese leader Xi Jinping and the need to promote trade relations with the European continent and the Western Balkans 41

VIZITË E MIRËPRITUR E PRESIDENTIT XI JINPING NË EUROPË!



Nga DR. JORGJI KOTE

Mjeshtër i Madh në diplomaci


Më 5 – 10 Maj 2024, Presidenti kinez Xi Jinping do të vizitojë Parisin, Beogradin dhe Budapestin. Ky tur kinez i nivelit më të lartë në Europë përbën një ngjarje të shënuar politike. Kur Europa ka hyrë në fushatën e zgjedhjeve përcaktuese

për Parlamentin European më 6 – 9 Qershor. Ndërkohë që po kërkon përgjigje për sfida të shumta, ku megjithë tensionet ekzistuese, kontributi kinez është i domosdoshëm. Mjaft të përmendim ndryshimet klimatike, tregtinë botërore, krizën në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme, të cilat janë vendimtare për paqen, sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar.

Ndalesa e parë dhe kryesore e Presidentit Xi Jinping në Paris rikonfirmon marrëdhëniet dhe rolin e veçantë kino-franceze në skenën botërore. Kjo “vizitë shteti” d.m.th me ceremonialin më të lartë protokollar përkon me 60-vjetorin e marrëdhënieve të tyre diplomatike; një mundësi

dhe sfond i përshtatshëm historik për bisedime me qasje konstruktive, megjithë “ujërat e turbulluara” që kanë rrjedhur vitet e fundit. Kina është partneri i tretë më i madh për Francën në Azi; të dyja janë anëtare të përhershme e KS të OKB-së, me shumë ndikim në institucionet e tjera ndërkombëtare. Dihet se Presidenti Macron ka shprehur dëshirën që çdo vit të vizitojë Pekinin dhe të ftojë homologun kinez në Paris.

Ndalesa e dytë në Beograd dëshmon se Serbia është mjaft aktive në marrëdhëniet me Kinën, sidomos në Projektin “Një brez një rrugë”. Veç kësaj, siç e cilësojnë dhe BE me SHBA, Serbia është vend kyç për sta-



bilitetin në Ballkanin Perëndimor, ku Kina tregon vëmendje të posaçme. Në vitin 2009 Pekini nënshkroi me Beogradin një aleancë strategjike dhe marrëveshjen e parë të tregtisë së lirë me një vend të Europës Qendrore dhe Lindore.


Edhe ndalesa në Budapest tregon nivelin e lartë të marrëdhënieve me Hungarinë, përfaqësues i Europës Qendrore dhe Lindore dhe aktive në mekanizmin e bashkëpunimit Kinë-EQL, me tregues domethënës në fusha jetike dypalëshe.

Nëpërmjet Serbisë dhe Hungarisë, Kina synon të forcojë bashkëpunimin dhe partneritetin me Europën Qendrore dhe Lindore.

Sfondit dhe “skenografisë” së kësaj vizite i kanë paraprirë takimet nëntorin e kaluar në SHBA me Presidentin Joe Biden, çka solli ulje të tensioneve mes tyre; dhjetorin e kaluar Xi Jinping priti në Pekin të tri krerët e BE-së, më 15 Prill Kancelarin gjerman Olaf Scholz dhe më 25 Prill Sekretarin amerikan të Shtetit Blinken, mbas rritjes së tensioneve dypalëshe.

Pa dyshim që vizita e tanishme është një rast i volitshëm për të analizuar politikën e këtyre tri vendeve dhe ato përfundimtare në përgjithësi ndaj Pekinit; pse jo, duke parë realisht dhe se ku dhe si ato kanë gabuar dhe pasojat, pa përjashtuar dhe “mëkatet” kineze. Mbi këtë bazë, të ofrohen zgjidhje të qëndrueshme, veçse me pragmatizëm realpolitik, jo me ballafaqime ideologjike dhe ushtarake.

Për disa arsye bindëse besohet se kjo vizitë do të mishërojë diplomacinë e njohur kineze të “sharmit dhe fuqisë së butë”.



Për disa arsye bindëse besohet se kjo vizitë do të mishërojë diplomacinë e njohur kineze të “sharmit dhe fuqisë së butë”. Ajo ka të ngjarë të shoqërohet me demarshe pozitive, me tone të moderuara, në përpjekje për të çtëndosur dhe qetësuar situatat dhe me vështrim nga e ardhmja bashkëpunuese. Me një ndër synimet kryesore, sqarimin dhe sheshimin e keqkuptimeve dhe keqperceptimeve për të gjitha palët.

Ajo ka të ngjarë të shoqërohet me demarshe pozitive, me tone të moderuara, në përpjekje për të çtëndosur dhe qetësuar situatat dhe me vështrim nga e ardhmja bashkëpunuese. Me një ndër synimet kryesore, sqarimin dhe sheshimin e keqkupti-

meve dhe keqperceptimeve për të gjitha palët.

Pritet që Presidenti Xi Jinping të përcjellë mesazhe afruese dhe pajtuese, duke u ndalur kryesisht në komponentët bashkues, duke lënë mënjanë vijat ndarëse. Presidenti Xi Jinping i mëshon idesë se tani që bota ka hyrë në një epokë turbulencash dhe rreziqesh deri te ato bërthamore, bashkëpunimi midis liderëve të fuqive të mëdha është domosdoshmëri parësore urgjente. Ndaj pritët që ai të ripërtërijë mesazhin që “së bashku mund t’i japim më shumë stabilitet dhe siguri botës”.

Kjo vlen veçanërisht për luftën në Ukrainë, e cila sidomos në Paris do të jetë në krye të “menusë” presidenciale, në përpjekje për të përafuar këndvështrimet e ndryshme të palëve. Me konkretisht, lidhur me Konferencën e Paqes, e propozuar për t’u mbajtur në Zvicër më 15 – 16 Qershor, Kina kërkon praninë e Rusisë; ndryshe konferenca nuk ka kuptim ose duhet të ketë emër tjetër por sërish pa

kuptim. Këtu do përmendur fjalë domethënëse e Presidentit kinez "të gjithë në tryezë dhe asnjë në kartën e menuesë" çka nënkupton praninë ruse por ndoshta dhe kundërshtimin nën zë të pushtimit të Ukrainës. Kjo çështje është përcaktuese për marrëdhëniet e Perëndimit me Kinën dhe fatet e luftës në Ukrainë. Ndaj, diplomacia perëndimore e krizës duhet t'i dëgjojë të gjithë aktorët dhe faktorët, pa përjashtuar asnjë alternativë, ca më tepër kur vjen nga Kina. Aspekt tjetër madhor, sidomos gjatë takimit me Presidentin Macron, do të jetë forcimi i marrëdhënieve kino-europiane, pa dëmtuar por dhe pa qenë të varur totalisht nga aleanca me SHBA-të. Mbas vizitës vitin e kaluar në Kinë, por dhe më 24 Prill në Sorbonë, Macron nënvizoi "autonominë strategjike"; duke u shprehur kundër krizave që nuk i takojnë Europës dhe që pengojnë funksionimin e saj".

Kjo është një pikë delikate për BE-në, nisur nga interesat e sigurisë me SHBA-të, për të cilat Kina shpreh mirëkuptim dhe po tregohet më realiste kohët e fundit, pavarësisht kritikave hera herës me doza të tepruara për këtë varësi europiane.

Gjithsesi, Presidenti Xi do të përqendrohet në dosjet më të rëndësishme politike, diplomatike, ekonomike dhe kulturore; diçka e natyrshme, mbasi aty çështjet me përfitim dhe interes të përbashkët janë mbizotëruese; por dhe dallimet apo kundërshtitë kapërcehen më lehtë, duke ndihmuar në zgjidhjen e problemeve më komplekse.

Kina mbron pikëpamjen se "për aq kohë sa do t'i përmbahemi respektit të ndërsjellë dhe kërkimit të elementëve të përbashkët, pavarësisht diferencave përkatëse, marrëdhëniet dypalëshe mund të zhvillohen në mënyrë

të qëndrueshme".

Më konkretisht, Presidenti Xi Jinping do të përsëritë mesazhin e Samitit BE – Kinë dhjetorin e kaluar në Pekin se "ndarja" e marrëdhënieve dhe de-riskimi me Kinën nuk janë opsione realiste dhe produktive". Apo siç theksoi gjatë takimit me Kancelarin Scholz në Pekin "Marrëdhëniet me Kinën nuk janë risk, por shans dhe mundësi zhvillimi". Në këtë drejtim, Kina kërkon dialog të vazhdueshëm në vend të sanksioneve dhe represaljeve ekonomike, të cilat nuk kanë dhënë rezultate.

Ja pse nga Franca, por dhe vendet e tjera perëndimore në marrëdhëniet me Kinën kërkohet realizëm gjeopolitik. Strategjitë e reja të disa vendeve perëndimore e cilësojnë Kinën partnere, konkurrencte dhe rivale sistematike, ndërsa pretendimet e tyre për një "politikë të jashtme të mbështetur në vlera dhe parime" tingëllojnë vërtet "muzikë e bukur". Mirëpo, siç kanë ardhur punët, zbatimi i tyre në praktikë dhe veçanërisht në fushën jetike ekonomike dhe të investimeve dypalëshe është pothuajse i pamundur.

Këto faktorë ndoshta ndikuan që Kancelari Scholz ta niste vizitën tre ditore në Kinë në Schongqingun tregtar, ndër qytetet më të mëdha të botës me 32 milion banorë, ku janë aktive 84 kompani gjermane, vijoi në Shangain ekonomik dhe përfundoi në Pekinin politik. Dhe kjo ishte vizita e dytë e tij brenda 2 viteve, ndërsa paraardhësjaja e tij, Kancelarja Merkel ishte atje plot 14 herë në 16 vite në pushtet!


Këtu nga Perëndimi kërkohet



në radhë të parë sinqeritet, “për të mos i rënë në qafë” Kinës për çdo gabim gjeopolitik. Qoftë dhe për shpenzimet ushtarake, kur sipas të dhënave të Institutit suedez për Paqe për vitin 2023, Kina zë vetëm 12 për qind, ndërsa SHBA-të 37 për qind të këtyre shpenzimeve botërore; mbi gjysmën e tyre e zënë vendet e NATO-s!

Më tej, nuk ia ka fajin askush Gjermanisë, Francës dhe BE-së në përgjithësi për varësinë e tyre të madhe ekonomike nga Kina, ndonëse dhe përfitimet e tyre kanë qenë të konsiderueshme. Kështu, vitin e kaluar, shitjet gjermane në Kinë përfaqësonin 48,5 për qind të eksporteve europiane; ose 99,8 për qind e eksportit francez të konjakut shkon në Kinë. Mirëpo, ekonomia për gjermanët, francezët dhe krejt Europën tani është kthyer në faktor vendimtar për mbijetesën e qeverisë dhe suksesin në zgjedhje. Gjatë vitit 2023, BE-ja pati një rritje ekonomike 1 për qind, Gjermania 0,1 nga 1, 3 për qind e parashikuar, ndërsa ajo franceze 0,8 për qind, nga 2,9 për qind më 2022. Ndërsa ekonomia kineze u rrit 5,3 nga 4,5 për qind e parashikuar. Kështu, për të tetin vit rresht, Kina është partneri më i madh tregtar për Gjermaninë dhe i treti më i madh për Francën në Azi. Rrjedhimisht, pa eksporte dhe investime në Kinë, ekonomitë europiane, sidomos ajo gjermane dhe franceze, etj. kanë pak shanse të mbijetojnë; mirëpo mbas tyre fshihen premtimet të shumta zgjedhore.

Pohimi i Ding Chun, profesor i studimeve europiane në Universitetin e Fudanit se” Gjermania



jo vetëm nuk “shkëputet” dot, por ajo ka nevojë të mbajë dhe thellojë shkëmbimet ekonomike dhe tregtare me Kinën” vlen dhe për Francën dhe vende të tjera të BE-së.

Gjithsesi, pavarësisht nga debatet dhe problemet, po ndodh ajo që theksonte në muajin Mars në Berlin ambasadori kinez, Wu Ken, se firmat gjermane ia kanë dhënë “votëbesimin” tregut kinez, duke treguar fuqinë e raporteve ekonomike dypalëshe“ Faktikisht, e “vërteta e shëmtuar“ siç thuhet është se vitet e fundit në Europë, sidomos në Gjermani dhe Francë, megjithë debatet kundërthënëse mbi bashkëpunimin ekonomik me Kinën, fuqia gjermane, franceze, europiane është e lidhur ngushtë me marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare me Kinën.

Natyrisht grindjet dhe konfliktet tregtare me Kinën mund të vijnë, madje, ato janë të pashmangshme dhe midis vendeve perëndimore; kujtojmë këtu luftën e gjatë tregtare SHBA – BE për çelikun dhe tekstilet.

Gjithsesi, takimet e Presidentit kinez në Uashington, Pekin dhe besojmë dhe tani në Europë dëshmojnë se nga pikëpamja gjeopolitike, realizmi dhe instinkti i mbijetesës në vendet perëndimore do të vazhdojë të sundojë mbi idealizmin, dhe realpolitika mbi diplomacinë misionare. Shkurt hesapi, pa një “aleancë konvencence“ me Kinën, shtetet europiane vështirë se mund t’ia dalin në politikën e tyre sociale, ekonomike, mjedisore, etj.

Ja pse turi i tanishëm European i Presidentit kinez Xi Jinping është i mirëpritur!


DIPLOMACIA E KREUT TË SHTETIT NË AKSION: XI, MACRON DHE DINAMIKAT E EUROAZISË



Nga Dr. Marsela MUSABELLIU

Pas pesë vitesh presidenti kinez rikthehet për një vizitë shtetërore në Evropë ku tapeti i kuq u shtrua në Paris në sfondin e një peisazhi kontinental që është shumë e ndryshme nga pesë vite më parë. Ndalesa e dytë në agjendë është Serbia, dhe e treta Hungaria. Duke nënvizuar stabilitetin e qëndrueshëm dhe momentin pozitiv në marrëdhëniet midis Kinës dhe këtyre tre kombeve, pavarësisht ndryshimeve dhe sfidave globale, është e qartë se po hidhen bazat për një kapitull të ri në angazhimin e Kinës me Evropën.

Nuancat e kësaj vizite presidenciale janë të larmishme, duke marrë parasysh destinacionet e përzgjedhura, dinamikën në zhvillim mes Kinës dhe kombeve që Xi viziton si dhe implikimet më të gjera gjeopolitike e globale. Zgjedhja e destinacioneve për vizitën e tij ka qartazi



një rëndësi strategjike, por edhe simbolike. Franca, si një nga fuqitë e shquara perëndimore, përfaqëson një rrugë vendimtare për Kinën për t'u angazhuar me Perëndimin. Hapja e Francës ndaj dialogut me Kinën paraqet një mundësi për të artikuluar perspektivat e Kinës dhe për të nxitur bashkëpunimin dypalësh.

Marrëdhëniet Kinë-Francë në fokus

Franca ka qenë përherë thelbësore në marrëdhëniet Kinë-Perëndim, ishte kombi i parë

i madh perëndimor që vendosi lidhje diplomatike me Kinën. Pavarësisht nga luhajtjet në marrëdhëniet Kinë-BE, Kina dhe Franca kanë mbajtur bashkëpunim të qëndrueshëm për çështjet e qeverisjes globale, një dëshmi e rëndësisë së diplomacisë së nivelit të lartë. Presidenti kinez Xi Jinping theksoi rëndësinë e marrëdhënieve Kinë-Francë, duke i quajtur ato si një fener bashkëpunimi midis kombeve me sisteme të ndryshme shoqërore. Në një deklaratë me shkrim para mbërritjes së tij në Paris për "Le Figaro", Xi



theksoi rolin kryesor të këtyre marrëdhënieve, historinë e pasur të shkëmbimit intelektual dhe përshëndeti hapat e fundit në bashkëpunimin dypalësh. Xi theksoi natyrën reciprokisht të dobishme të marrëdhënieve të thelluara, e cila jo vetëm pasuron lidhjet dypalëshe, por gjithashtu kontribuon pozitivisht në stabilitetin global. Duke reflektuar mbi historinë e pasur që lidh të dy kombet theksoi vendimin vizionar të gjeneralit Charles de Gaulle për të krijuar lidhje me Kinën e Re mes kompleksitetit të epokës së Luftës së Ftohtë, dhe duke hedhur themelet për një partneritet të bazuar në dialog dhe bashkëpunim.

Ndër dekada, dhe nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta, Kina dhe Franca kanë kultivuar jo vetëm një komunikim efektiv strategjik, por edhe historik bashkëpunimi praktik, duke pasuruar shkëmbimet mes popujve dhe kulturave të tyre dhe duke harmonizuar zërat e tyre në arenën globale. Fokusi i vi-

zitës së Xi është dëshmi e roleve kryesore që pritet të luajnë këta anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Përgjegjësitë e tyre shtrihen përtej diplomacisë së thjeshtë; atyre u është besuar stabilizimi i industrive globale e zinxhirëve të furnizimit, dhe fanarë si roje të paqes dhe stabilitetit botëror. Potenciali për thellimin e bashkëpunimit midis Kinës dhe Francës nuk njihet kufij, mjafton të mendohet se aktualisht janë mbi 40,000 francezë që po studiojnë kinezisht dhe duket sfondi i interesave të së ardhmes. Ndërsa Franca dhe Republika Popullore e Kinës festojnë 60 vjetorin e lidhjeve diplomatike, Parisi synon të vendoset si një partner i besueshëm ndërkombëtar, duke nxitur marrëdhënie miqësore me Pekinin.

Kinë-BE dhe epiqendra parisiane e kontinentit

Miqësia e qëndrueshme midis Kinës dhe Francës jo vetëm që

forcon lidhjet e tyre dypalëshe, por gjithashtu mban potencialin për të forcuar marrëdhëniet më të gjera Kinë-BE. Ndërsa Xi dhe Macron angazhohen në këto diskutime madhore si lojtarë globalë, ata kanë fuqinë për të ngritur partneritetin e tyre në lartësi të reja, duke nxitur një marrëdhënie më të qëndrueshme Kinë-BE. Franca mbështet idenë e një Evrope të fortë dhe autonomisë strategjike, e cila përputhet me dëshirën e Kinës për një botë shumëpolare. Agjenda dypalëshe midis BE-së dhe Kinës ndër vite ka pasur shumë prioritete, në varësi të kohërave dhe eventeve ndërkombëtare. Ndërsa vendet evropiane dhe BE-ja e kuptojnë se bashkëpunimi me Kinën është i domosdoshëm për shumë çështje, ata ende theksojnë se zhvillimi i Kinës sjell konkurrencë, jo vetëm ekonomikisht dhe teknologjikisht, por edhe për sa i përket sistemeve politike dhe modeleve të qeverisjes. Prandaj, Evropa e ka identifikuar Kinën

si një partnere bashkëpunimi, një konkurrencte ekonomike dhe një rivale sistematike që nga viti 2019. Kjo ka pasur një ndikim disi negativ në formulimin dhe zbatimin e politikave të Evropës për Kinën. Por, me këtë vizitë vihet re se Evropa dhe disa nga krerët e saj po marrin një qasje tjetër kundrejt Kinës, atë për zhvillimin e mëtejshëm të partneritetit të tyre strategjik gjithëpërfshirës. Ka ardhur koha, dhe kjo vizitë e nivelit të lartë e tregoi, se palët duhet të ulen në tryezën e bisedimeve për bashkëpunim më të intensifikuar.

Kina dhe Evropa kanë interesa të gjera të përbashkëta. Bashkëpunimi është më i madh se konkurrenca dhe mendimet unanime janë më të shumta se mosmarrëveshjet. Kina i trajton gjithmonë marrëdhëniet me Evropën nga këndvështrimi strategjik afatgjatë, duke ruajtur qëndrueshmërinë e politikës ndaj Evropës.. Angazhimet midis Kinës dhe Evropës nënvizojnë një prirje më të gjerë të shkëmbimeve të nivelit të lartë, duke nxitur lidhje më të thella ekonomike dhe

diplomatike. Pavarësisht sfidave të paraqitura nga narrativat e ndryshme, të dyja palët njohin mundësitë e jashtëzakonshme për bashkëpunim.

Në këtë linjë presidenti kinez Xi Jinping, presidenti francez Emmanuel Macron dhe presidentja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen u mbledhën për një takim trepalësh në Pallatin Elysee në Paris më 6 maj. Xi shprehu kënaqësinë e tij për ribashkimin me ta, duke theksuar rëndësinë e takimit trepalësh në rritjen e rëndësisë më të gjerë evropiane të vizitës së tij.

Xi e portretizoi Evropën si një dimension jetik në diplomacinë e Kinës si një fuqi e madhe me karakteristika të dallueshme dhe si një partner vendimtar në ndjekjen e saj të modernizimit. Ai kërkoi dialog të qëndrueshëm, bashkëpunim, komunikim strategjik, ndërtimin e besimit, ndërtimin e konsensusit, koordinimin dhe përpjekjet e bashkërenduara për të siguruar një rritje të qëndrueshme dhe të shëndetshme të marrëdhënieve Kinë-BE, duke kon-

tribuar në paqen dhe zhvillimin global.

Dhe patjetër, më vonë në fokus ishte dhe konflikti Rusi-Ukrainë. Lidhur me krizën në Ukrainë; Xi sqaroi se Kina nuk rreshtohet me asnjë palë në konflikt, por përkundrazi përpiket të luajë një rol konstruktiv për paqen. Xi dënoi çdo përpjekje për të shfrytëzuar krizën në Ukrainë, për të fyer një palë të tretë, ose për të provokuar një Luftë të re të Ftohtë. Ai theksoi domosdoshmërinë e negociatave për zgjidhjen e konflikteve, duke u bërë thirrje të gjitha palëve që të rifillojnë dialogun për të rindërtuar besimin reciprok. Ai shprehu mbështetjen e Kinës për krijimin e një kuadri sigurie të balancuar, efektive dhe të qëndrueshme në Evropë. Xi dhe Macron ...

Presidenti Xi është shprehur shpesh për ndikimin dhe shkëmbimet midis qytetërimeve kineze dhe franceze. Duhet thenë gjithashtu se disa nga gjenerata e parë e liderëve të Partisë Komuniste të Kinës kanë studiuar në Francë, si Zhou Enlai, Deng Xiaoping, etj. Për shkak të kësaj, tha Xi, “kam zhvilluar një interes të madh në kulturën franceze dhe veçanërisht historinë, filozofinë, letërsinë dhe artin francez kur isha i ri”. Ai është shprehur se si e kanë frymëzuar intelektualët nga Franca. Leximi i Montesquieu, Voltaire, Rousseau, Diderot, Saint-Simon, Fourier dhe Sartre ka thelluar të kuptuarit e tij se si përparimi i mendjes nxit përparimin në shoqëri. “Leximi i Montaigne, La Fontaine, Molière, Stendhal, Balzac, Hugo, Dumas, Maupassant, etj... më kanë ndihmuar të vlerësoj mirë jetën me të gjitha gëzimet dhe



hidhërimet e saj”, është shprehur Xi. Shumë të rinj patriotë kinezë u frymëzuan nga shkriimet mbi Revolucionin Francëz, i cili është gjithashtu sfondi i “Të Mjerët” e Hugos, një nga kryeveprat franceze më të cituara të Xi. Pra, është vënë re pozitiviteti i madh i shprehur nga Xi kundrejt Francës, kundrejt filozofisë së tyre, sociale dhe njerëzore.

Një aspekt qendror i vizitës së presidentit Xi është angazhimi me presidentin francez Macron. Lideri më i ri në moshë i Francës që nga Napoleoni, Macron mbart një trashëgimi të gjatë diplomacie. Elementi tjetër midis Xi dhe Macron është një qasje personale, një afrimet nga të dy që nuk është vënë re shpesh me liderë të tjerë. Gjatë vizitës së tij në Kinë në 2023, Xi Jinping, ftoi Macron në rezidencën e guvernatorit të Guangdong, që ishte një post i mbajtur nga babai i Xi Jinping. Ndërsa Macron, duke ftuar presidentin Xi Jinping në një cep të maleve të Pireneje, ku ai kaloi shumë nga fëmijëria me gjyshen e tij, tregon një gjest tejet personal edhe nga ana e Macron. Afiniteti i të dyve u pa dhe u komentua gjerë në Evropë e më tej.

Nga ana tjetër qëndrimi i Macron ndaj Kinës, veçanërisht në kontekstin e politikës dhe sigurisë globale, shton kompleksitetin e diskutimeve. Ndërsa Macron ka theksuar dëshirën e Francës për autonomi në politikën e jashtme, ai gjithashtu pranon rëndësinë e bashkëpunimit me Kinën në fronte të ndryshme. Kjo qasje e nuancuar pasqyron aktin balancues të Francës midis aleancave të saj tradicionale dhe partneriteteve



në zhvillim. Macron në Pekin, në vizitën e tij vitin e kaluar është shprehur se Evropa nuk duhet të ndjekë politikën e SHBA-ve mbi Tajvanin. Edhe në Shtetet e Bashkuara, është rënë dakord që Macron është shfaqur si një lider i rëndësishëm global, falë jo vetëm ndikimit të BE-së në çështjet ekonomike, por edhe pozicionit unik të Francës si një fuqi e madhe që rreshtohet shpesh me SHBA-në por duke ruajtur pavarësinë e saj. Dhe për të parafrazuar një nga ato legjendat urbane me origjinë të dyshimtë (që përgjithësisht i atribuohen Henry Kissinger-it), ka pak dyshim se kur Presidenti i Shteteve të Bashkuara dëshiron të telefonojë Evropën, kodi ndërkombëtar që ai përdor tani është +33.

Së fundmi, Kina e ka bërë shumë të qartë, për një kohë të gjatë, se kërkon marrëdhënie bashkëpunuese me Evropën. Dhe sigurisht në thelb nuk ka ndonjë konflikt jetësor midis tyre, pra, bazat objektive materiale për marrëdhënie të forta janë prezente. Është vetëm një çështje nëse, psikologjikisht dhe emocionalisht Evropianët dhe fuqitë


transatlantike janë në gjendje të pranojnë realitetin e një bote në ndryshim me baza multilateralizmin. Një dialog i frytshëm midis Kinës dhe Francës, del në diskursin global si fije shprese në një botë që shpesh është nën hijen e manovrave gjeopolitike dritëshkurtër.

Është e rëndësishme t'i konsiderojmë këto marrëdhënie jo në terma transaksionale por në kohë të gjerë tranzicioni dhe qasje historike. Turneu i Xi nxjerr në pah dinamikën në zhvillim të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndryshimin e ekuilibrit të fuqisë globale. Franca dhe Macron po duket se do të kalibrojnë marrëdhëniet e saj në drejtime të ndryshme dhe takime të këtij lloji të kontribuojnë si një kanal shtesë komunikimi në nivel gjeopolitik. Kina po ndryshon, Evropa po ndryshon dhe po ashtu edhe marrëdhëniet shumëpalëshe po ndryshojnë. Ndryshimi është absolut dhe detyra e liderëve politikë është që të menaxhojnë si duhet ndryshimin në ruajtje të paqes, prosperitetit dhe progresit, për të gjithë.

PARIS, BEOGRAD, BUDAPEST: NJË VËSHTRIM BRENDË TURNEUT EVROPIAN TË XI JINPING



Nga Marjana DODA



Turi Evropian i Presidentit kinez Xi Jinping, konkretisht në Francë, Hungari, Serbi, shihet si një hap tjetër drejt rindërtimit të besimit me kontinentin, me fokus bashkëpunimin pragmatik, pavarësisht fërkimeve gjeopolitike.

Në një epokë ku tensionet gjeopolitike shpesh dominojnë në marrëdhëniet shumëpalëshe, marrëdhëniet midis Kinës dhe BE-së shërben si një testament për përfitimet e bashkëpunimit ekonomik. Si dy nga ekonomitë më të rëndësishme të botës, Kina dhe BE-ja kanë kultivuar një marrëdhënie që ndikon ndjeshëm në tregtinë globale dhe stabilitetin ekonomik.

Marjana Doda

Presidenti kinez Xi Jinping e nisi turin e tij nga Franca si ndalesa e parë e vizitës së tij shtetërore në tre vendet e BE-së. Kjo vizitë tregon një domodoshmeri në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të

shëndetshëm të marrëdhënieve Kinë-Evropë, është një garanci e stabilitetit dhe sigurisë në situatën aktuale të trazuar botërore, duke dhënë shtysë të mëtejshme për bashkëpunimin dhe rritjen globale.

Lidhjet midis Kinës dhe Bashkimit Evropian janë të ndryshme dhe kanë ndikim të madh në politikën globale, tregtinë, dhe shumë aspekte të tjera të marrëdhënieve ndërkombëtare. Disa elemente kryesore të rëndësishme të këtyre lidhjeve janë:

Tregtia: Kinës dhe Bashkimit Evropian janë dy prej subjekteve më të mëdha ekonomike në botë. Lidhjet tregtare midis tyre kanë një impakt të madh në zhvillimin ekonomik të të dyja palëve. **Investimet:** Kinë dhe BE janë njëra prej partnerëve më të

rëndësishëm të investimeve reciproke. Investimet kineze në Evropë dhe anasjelltas kanë ndikim në zhvillimin ekonomik dhe politik të të dy rajoneve.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar: Kinës dhe BE-së shpesh herë u takojnë në forume ndërkombëtare, duke përfshirë Organizatën e Kombeve të Bashkuara, G20, etj., ku bashkëpunimi dhe negociatat janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjeve globale.

Këto janë disa prej elementeve kryesore që tregojnë rëndësinë e lidhjeve midis Kinës dhe Bashkimit Evropian.

Situata gjeopolitike globale gjithashtu ka një ndikim të madh në afrimin midis Kinës dhe Bashkimit Evropian. Ndërveprimet gjeopolitike mund të ndikojnë në mënyrën se si Kinë- BE

përqendrohen ndaj njëra-tjetrës. Në disa raste, tensionet gjeopolitike mund të përkeqësojnë marrëdhëniet, ndërsa në raste të tjera, ato mund të shtyjnë për bashkëpunim më të ngushtë.

Për rrjedhojë, situata gjeopolitike globale ka një ndikim të rëndësishëm në marrëdhëniet midis Kinës dhe Bashkimit Evropian, duke formuar dhe modeluar mënyrën se si ato bashkëpunojnë dhe konkurrojnë në sfera të ndryshme.

Bashkimi Evropian dhe Kina janë të interesuara që të mbrojnë interesat e tyre kombëtare dhe rajonale në këto kontekste, ndaj dhe kjo vizitë e udhëheqësit kinëz shënoi një tjetër hap të rëndësishëm për forcimin e kësaj marrëdhënie mes dy kontinenteve.

Bota është në rrezik nga konfliktet dhe luftra në horizonte të ndryshme të botës, nga Europa në Lindjen e mesme dhe më gjerë. Ndaj kjo vizitë padiskutim ka dhe një mision të rëndësishëm, krijimin e urave të bashkëpunimit, për të ndërtuar besimin ndërshtetëror dhe për të garantuar paqen në botë.

Pekin-Paris, 60 vite miqësi

Pekini dhe Parisi shënojnë 60 vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, me Francën vendi i parë perëndimor që njohu zyrtarisht Republikën Popullore të Kinës më 27 janar 1964

“Që nga njohja e Kinës nga Franca më 27 janar 1964, marrëdhëniet midis dy palëve kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme dhe janë rritur në mënyrë të qëndrueshme, duke ngritur nivelin e “partneritetit strategjik global” që nga viti 2004.



Nga një këndvështrim strategjik, të dy vendet janë angazhuar në një dialog, duke mbuluar të gjitha fushat e bashkëpunimit, duke përfshirë reformimin e qeverisjes globale, ndryshimet klimatike dhe krizat rajonale.

Siç tha presidenti Xi “si një nga pjesëmarrësit më të hershëm në reformën dhe hapjen e Kinës, Franca ka kontribuar në përpjekjen e modernizimit të Kinës dhe ka përfituar prej tij. Miqësia më e thellë kërkon shkëmbime të shpeshta dhe bashkëpunim më të ngushtë.” Franca është partne-

ri i tretë tregtar i Kinës dhe Kina është burimi i tretë më i madh i investimeve reale në Bashkimin Evropian (BE). Franca është partneri më i madh tregtar i Kinës në Azi dhe i shtati më i madhi në botë.

Pavarësisht ndërprerjeve globale, Kina ka mbetur partneri më i madh tregtar i BE-së, me vëllime tregtare që arrijnë mbi 783 miliardë dollarë në vitin 2023. Kjo përfaqëson një mesatare prej gati 1.5 milionë dollarë shkëmbime tregtare në minutë. Ndërvare-



“Që nga njohja e Kinës nga Franca më 27 janar 1964, marrëdhëniet midis dy palëve kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme dhe janë rritur në mënyrë të qëndrueshme, duke ngritur nivelin e “partneritetit strategjik global” që nga viti 2004. Nga një këndvështrim strategjik, të dy vendet janë angazhuar në një dialog, duke mbuluar të gjitha fushat e bashkëpunimit, duke përfshirë reformimin e qeverisjes globale, ndryshimet klimatike dhe krizat rajonale.



sia ekonomike Kinë-BE shërben si një tregues i qartë se të dyja palët kanë arritur dhe mund të vazhdojnë të arrijnë më shumë përmes bashkëpunimit dhe konkurrencës së shëndetshme sesa përmes konfrontimit antagonist dhe rival.

Në këtë vit jubilar për të dy vendet, si dy shtylla kryesore në Europë dhe Azi, gjatë kësaj vizite shtetërore, lideret Xi Jinping dhe Emmanuel Macron, kanë rikonfirmuar angazhimin e tyre për të thelluar marrëdhëniet dypalëshe, dhe të konsolidojnë stabilitetin strategjik mes dy vendeve.

Por jo vetem kaq, kjo vizitë në Paris, sqaroi edhe njëherë qëndrimin e Kinës përballë krizave dhe konflikteve në Europë dhe Lindje, duke u zotuar për paqe dhe stabilitet në botë.

Bota e sotme është larg nga të qenit e qetë. Kina dhe Franca, si anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, theksuan faktin se duhet të flasin për zgjidhjen paqësore të çështjeve të pikave të nxehta dhe të kontribuojnë në një botë me paqe të qëndrueshme dhe siguri të përbashkët.

Partneriteti i “hekurt” Kinë-Serbi

Është ky një slogan që ka shoqëruar këtë udhëtim të Presidentit të Kinës Xi Jinping në Serbi.

Kina është e gatshme të punojë me Serbinë për të mbështetur miqësinë e hekurt, për të mbrojtur interesat themelore dhe afatgjata të të dy vendeve dhe për të ndjekur zhvillimin dhe përtëritjen përkatëse kombëtare, duke synuar të promovojë ndërtimin e një komuniteti Kinë-Serbi me një të ardhme të përbashkët në epokës së re, tha presidenti kinez Xi Jinping gjatë takimit me presidentin serb Aleksandar Vuçiq në Beograd.

Serbia ishte vendi i parë i Evropës Qendrore dhe Lindore që u bë partneri strategjik gjithëpërfshirës i Kinës tetë vjet më parë.

Investimet kineze në infrastrukturën e Serbisë kanë qenë të rëndësishme në përmirësimin dhe zgjerimin e rrjeteve kritike të transportit, objekteve të energjisë dhe sistemeve të telekomunikacionit. Ky infuzion i kapitalit ka ndihmuar në modernizimin e

infrastrukturës së Serbisë, duke përmirësuar lidhjen brenda vendit dhe me rajonet fqinje. Për shembull, projekte si hekurudha Beograd-Budapest dhe ndërtimi i autostradës kanë përmirësuar lidhjet e transportit, duke lehtësuar tregtinë dhe rritjen ekonomike.

Bashkëpunimi ekonomik Pekin-Beograd ka sjellë një mori mundësish për të dy vendet. Fabrika e çelikut HBIS Smederevo. E themeluar në vitin 1913, fabrika e çelikut u përshëndet si “krenaria e Serbisë” në ditët e saj të lavdisë, duke furnizuar rreth 40 përqind të të ardhurave fiskale të Smederevës dhe duke mbajtur gati një të tretën e banorëve të saj.

Kina dhe Serbia janë miq dhe partnerë të ngushtë, që ndajnë një miqësi të hekurt që i ka rezistuar provës së kohës dhe lulëzon pavarësisht ndryshimeve në peizazhin global. Në tetor 2023, presidenti Vuçiq mori pjesë në Forumin e Tretë Brezi dhe Rruga për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Pekin. Në margjinat e forumit, të dy vendet nënshkruan marrëveshjen e tregtisë së lirë Kinë-Serbi (MTL), e para marrëveshje e tregtisë së lirë e nënshkruar midis Kinës dhe një vendi të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Presidenti kinez Xi Jinping deklaroi dikur se, “Modernizimi që po ndjekim nuk është vetëm për Kinën, por për të gjitha vendet në zhvillim nëpërmjet përpjekjeve tona të përbashkëta”. Vizita e tij aktuale shtetërore parashtohet të nxisë marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare midis dy kombeve, veçanërisht brenda kornizës së BRI.

Ndërsa Serbia luan një rol vendimtar në Iniciativën Brez dhe

Rrugë, duke shërbyer si një qendër strategjike për lidhjen, vizita e Presidentit Xi ofron mundësinë për të diskutuar zhvillimin e projekteve në vendin evropian. Duke qenë një partner kyç në këtë iniciativë, projektet e infrastrukturës së transportit të Serbisë mund të kontribuojnë në lidhjen rajonale që lidh Evropën dhe Azinë duke zgjeruar integrimin dhe zhvillimin ekonomik në të gjithë Ballkanin dhe më gjerë.

Marrëveshjet në vijimësi...

Presidenti kinez Xi Jinping dhe ai serb Aleksandar Vučić nënshkruan të mërkurën e 8 majit një deklaratë të përbashkët për ndërtimin e një komuniteti Kinë-Serbi me një të ardhme të përbashkët në epokën e re, duke e bërë Serbinë vendin e parë evropian që arrin një konsensus të tillë me Kinën.

Gjatë konferencës së përbashkët për shtyp, Xi njoftoi gjashtë masa për të mbështetur nismën. Me përpjekje të përbashkëta nga Kina dhe Serbia, marrëveshja e tregtisë së lirë mes dy vendeve do të hyjë në fuqi më 1 korrik, tha ai.

Kina mbështet Serbinë në pritjen e Expo 2027 dhe do të dërgojë një delegacion për të marrë pjesë në ngjarjen madhështore, tha Xi, duke shtuar se Kina inkurajon ndërmarrjet e saj të marrin pjesë në ndërtimin e projekteve përkatëse.

Kina është e gatshme të importojë më shumë produkte bujqësore cilësore dhe të dallueshme nga Serbia, tha ai.

Pala kineze do të ndihmojë 50 shkencëtarë të rinj serbë në programet e shkëmbimit me Kinën për tre vitet e ardhshme, dhe do të ftojë 300 të rinj serbë për të



studiuar në Kinë në tre vitet e ardhshme.

Në deklaratën e përbashkët, të dy vendet vendosën të thellojnë dhe partneritetin gjithëpërfshirës strategjik Kinë-Serbi, dhe për të ndërtuar një komunitet Kinë-Serbi me një të ardhme të përbashkët në epokën e re.

Lidhja Budapest-Pekin

Hungaria ishte vendi i parë i Evropës Lindore që nënshkroi iniciativën e Xi-së “Një brez dhe një rrugë” (BRI). Në përgjithësi, qasja pragmatike e Hungarisë ndaj marrëdhënieve të saj me Kinën u jep përparësi interesave ekonomike duke ruajtur sovranitetin dhe stabilitetin politik. Një fakt konkret që tregon se si një vend evropian ndryshe nga diskursi propagandistik, është shembulli i një bashkëpunimi të suksesshëm me Kinën.

Pak përpara vizitës së tij te kryeministri hungarez Viktor Orbán, lideri kinez Xi Jinping solli në vëmendje marrëdhëniet diplo-

matike 75-vjeçare të dy vendeve në një letër të botuar në mediat hungareze.

“Megjithëse të dy vendet ndahen nga një distancë e madhe gjeografike, miqësia midis popullit kinez dhe hungarez mund të mburret ende me një histori të gjatë,” theksoi Xi Jinping

Duke theksuar bashkëpunimin e tyre gjatë pandemisë Covid, kur Hungaria u bë vendi i parë i BE-së që autorizoi një vaksinë të prodhuar nga Kina, dhe bashkëpunim reciprok, udhëheqësi kinez vlerësoi Hungarinë si një “partner të rëndësishëm tregtar, duke theksuar se “bashkëpunimi i tyre është më i madh se konkurrenca e tyre dhe ka më shumë marrëveshje sesa mosmarrëveshje”.

Ky është dhe “lajtmotivi” i këtij turi evropian i udhëheqësit kinez Xi Jinping, që shtrin dorën për bashkëpunim, duke punuar sëbashku për të ndërtuar një komunitet me të ardhme të përbashkët.

KONFUCIZMI

“AXHENDA” FILOZOFIKE E VIZITËS SË PRESIDENTIT KINEZ, XI JINPING NË EUROPE



Nga Albert VATAJ

Udhëprini njerëzve me shembullin tuaj dhe bëhuni një mundësi e perspektivës së tyre”, këshillon Konfuci, ati shpirtërorë i një tradite brilante filozofike, në themel të së cilës qëndron; predikimi i moralit personal dhe qeveritarë, korrektësisë së mar-

rëdhënieve shoqërore, drejtësisë, mirësisë, sinqeritetit dhe përgjegjësisë.

Është ky definicion, i cili në vet-vete përcakton edhe caqet e pritshmërive të vizitë së Presidentit kinez, Xi Jinping, në maj 2024, në Francë, Serbi dhe Hungari.

Kina i kushton vëmendje të maksimizuar partneritetit me palën evropiane, bashkëpunimi dypalësh ka rëndësi të jashtëzakonshme për Kinë dhe Europën. Duke i parë dhe trajtuar ato me një prioritet të shtuar reciprocitetin edhe me vendet e ballkanike. Dhe në një prizëm më të gjerë, optimizmi i mundësive dhe kapaciteteve për një dina-

mizëm të diktuar nga zhvillimet globale, ku Kina i shpreh garancinë e prioriteteve të saj në fushën politike, ekonomike, të mbrojtjes së mjedisit, të paqes etj..

Turneu evropian i presidentit kinez Xi Jinping është i rëndësishëm për Evropën për disa arsye, ku besimi dhe bashkëpunimi politik janë piketa të rëndësishme prioritare. Xi ka bërë thirrje për rritjen e besimit të ndërsjellë politik, dialogut dhe bashkëpunimit me Bashkimin Evropian (BE). Padyshim që ky synim kalon nga përfshirja e ndërtimit të konsensusit strate-





gjik dhe marrjen në konsideratë të moslejimit të ndërhyrjeve, ku toleranca është e patolerueshme, gjë që është thelbësore për perspektivën e bashkëjetesës së cilësishme të qytetarëve ndër-vendase.

Marrëdhëniet BE-Kinë janë karakterizuar gjithmonë nga paqja dhe siguria, një rend botëror i bazuar në rregulla dhe një marrëdhënie e ekuilibruar tregtare. Situata aktuale ekonomike dhe gjeopolitike kërkon që BE-ja dhe Kina të komunikojnë hapur mbi numrin në rritje të çështjeve, si shkeljet e të drejtave të njeriut, çekuilibrat tregtare dhe ndërhyrjet e jashtme dhe gjetjen e një konsensusi.

“Jeta është vërtet e thjeshtë, por ne insistojmë ta komplikojmë” vërente Konfuci, dhe pikërisht për ta mundësuar gjetjen e zgjidhjeve përmes dialogut dhe

interesit reciprok, sugjerohet se urat e komunikimit, Kinës dhe BE-së kanë rëndësi strategjike për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin global. Mes një situatë gjithnjë e më të trazuar ndërkombëtare, kjo marrëdhënie shihet si një stabilitet më i madh për botën dhe një shtysë më e fortë për zhvillim.

Në një fokus do të jetë edhe komplementariteti ekonomik. Ekziston një shkallë e lartë komplementariteti midis ekonomive kineze dhe atyre të BE-së. Bashkëpunimi mund të rritet për të forcuar lidhjen e interesave të përbashkëta, e cila është e dobishme për të dyja palët. Kjo përmes ndërtimi i besimit. Turneu shihet gjithashtu si një hap drejt rindërtimit të besimit midis Kinës dhe Evropës. Ai synon të reduktojë perceptimet e gabuara dhe të fokusohet në bashkëpunimin pragmatik pavarësisht fërki-meve gjeopolitike.

Vendimi i Xi për të vizituar institucionet e BE-së është një njo-hje e rëndësishme politike në rritje të Bashkimit për Kinën, e cila mund të çojë në thelb dhe kuptim të mëtejshëm në përmirësimin e marrëdhënieve BE-Kinë. Në përgjithësi, turneu i Xi Jinping është një mundësi për Kinën dhe Evropën që të angazhohen në dialog kuptimplotë, të trajtojnë dallimet në mënyrë konstruktive dhe të eksplorojnë fusha me përfitim reciprok. Është një shans për të riafirmuar partneritetin e tyre gjithëpërfshirës strategjik dhe për të punuar drejt qëllimeve të përbashkëta në një peizazh kompleks ndërkombëtar.

Është kjo vizitë, kjo mundësi, ky sensibilitet, kjo qasje e marrëdhënieve Kinë-BE, që do të ofrojë shanset e një konsiderimi të të gjithë perimetrit ku zhvillimet udhëprijnë këtë vizitë, e cila nga pala kineze ka në themel mësi-

met e Konfucit që kanë ushqyer si një ligjësi në mënyrën se si vlerat etike, harmoninë sociale dhe sjelljen e duhur, kanë pasur një ndikim të thellë në kulturën dhe shoqërinë kineze. Kur merren parasysh marrëdhëniet BE-Kinë, këto parime mund të ofrojnë një kuadër filozofik për mirëkuptim dhe angazhim, specifiku:

Harmonia dhe Stabiliteti: Konfucianizmi vlerëson harmoninë dhe stabilitetin shoqëror, i cili përputhet me interesin e BE-së për të mbajtur një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të begatë me Kinën.

Respekti i ndërsjellë: Ideali konfucian i respektit të ndërsjellë dhe sjelljes së duhur në marrëdhënie mund të pasqyrohet në ndërveprimet diplomatike dhe negociatat midis BE-së dhe Kinës.

Perspektiva Afatgjatë: Konfucianizmi inkurajon një perspektivë afatgjatë, e cila mund të ndikojë në qasjen strategjike të BE-së dhe Kinës në formësimin e marrëdhënieve të tyre të ardhshme.

Qeverisja Etike: Konfuci mbrojt qeverisjen dhe udhëheqjen etike, e cila mund të jetë një bazë e përbashkët për dialogun mbi modelet e qeverisjes dhe çështjet e të drejtave të njeriut.

Arsimi dhe shkëmbimi kulturor: Theksi konfucian mbi arsimin përputhet me interesin e BE-së për shkëmbimet arsimore dhe kulturore si një mjet për të forcuar lidhjet dhe mirëkuptimin reciprok.

Ndërsa mësimet e Konfucit ofrojnë një lente kulturore, përmes së cilës mund të shihet marrëdhënia, aspektet praktike të mar-

rëdhënieve BE-Kinë formësohen nga konsideratat bashkëkohore politike, ekonomike dhe strategjike. Megjithatë, të kuptuarit e këtyre bazave kulturore mund të kontribuojë në një angazhim më kuptimplotë dhe të respektueshëm midis Evropës dhe Kinës.

Është kjo filozofi, përfaqësimi dhe përqaftimi i së cilës kanë shënuar një erë të re të historisë së marrëdhënieve BE-Kinë, të cilat në një sërë zhvillimesh, kanë formësuar dinamikën aktuale midis dy entiteteve. Kujtojmë, vendosja e marrëdhënieve. Bashkimi Evropian (BE) dhe Kina vendosën marrëdhënie dypalëshe në vitin 1975, pas njoh-



Vendimi i Xi për të vizituar institucionet e BE-së është një njohje e rëndësishme politike në rritje të Bashkimit për Kinën, e cila mund të çojë në thelb dhe kuptim të mëtejshëm në përmirësimin e marrëdhënieve BE-Kinë. Në përgjithësi, turneu i Xi Jinping është një mundësi për Kinën dhe Evropën që të angazhohen në dialog kuptimplotë, të trajtojnë dallimet në mënyrë konstruktive dhe të eksplorojnë fusha me përfitim reciprok. Është një shans për të riafirmuar partneritetin e tyre gjithëpërfshirës strategjik dhe për të punuar drejt qëllimeve të përbashkëta në një peizazh kompleks ndërkombëtar.

jes zyrtare të Republikës Popullore të Kinës nga shtetet anëtare të Komunitetit Evropian (KE) në fillim të viteve 1970. Për t'u pasuar nga rëndësia jetike e marrëveshjeve tregtare. Marrëveshja e parë tregtare ndërmjet KE-së dhe Kinës u nënshkrua në maj 1978, duke shënuar fillimin e marrëdhënieve formale ekonomike.

Ishte partneriteti Strategjik ai që hyri në fokus të këtij dinamizmi marrëdhëniesh. Gjatë tre dekadave të fundit, marrëdhënia ka evoluar nga angazhimi konstruktiv në një partneritet strategjik. Kjo përfshin bashkëpunimin në fusha të tilla si tregtia, shkenca dhe teknologjia, dhe siguria.

Ecuria u karakterizua nga rritja e tregtisë. Kina është bërë partneri i dytë më i madh tregtar i BE-së dhe BE-ja është bërë partneri më i madh tregtar i Kinës. Kjo ndërvarësi ekonomike ka qenë një aspekt i rëndësishëm i marrëdhënies së tyre, e pse edhe pjesë e interesimit të vizitës së Presidentit kinez.

Por, përgjatë implementimit të këtij partneriteti doli në skenë ulja e varësisë. Në maj 2021, Komisioni Evropian njoftoi planet për të reduktuar varësinë nga Kina në fushat strategjike të ekonomisë, duke sinjalizuar një zhvendosje drejt një qasjeje më të kujdesshme ndaj marrëdhënieve ekonomike.

Parë me një optikë reale nënvizojmë faktin se gjatë gjithë historisë së saj, marrëdhënia BE-Kinë kanë qenë komplekse, me të dyja palët duke lundruar nëpër periudha bashkëpunimi dhe tensioni. Relievat nëpër të cilat ju desh të vijonte norma-





liteti shpesh ishte i thyer, por kishte gjithnjë interes dhe vullnet për të sheshur dhe gjetur zgjidhje. Gjithsesi marrëdhënia BE-Kinë vazhdon të jetë një faktor i rëndësishëm në politikën dhe ekonominë globale, duke ndikuar në një gamë të gjerë çështjesh ndërkombëtare.

Pavarësisht problematikave që duke vënë në sprovë këto marrëdhënie, duke i kanë bërë ato më rezistente dhe më të qëndrueshme, shohin se vizita e presidentit kinez Xi Jinping në Evropë sjell disa përfitime të mundshme për kontinentin. Evropa do të përfitojë nga rritja e bashkëpunimit ekonomik me Kinën, pasi ekziston një shkallë e lartë e komplementaritetit midis ekonomive të tyre. Kjo mund të çojë në më shumë mundësi tregtare dhe investimesh.

Vizita ofron gjithashtu një platformë për komunikim strategjik,

duke i lejuar të dyja palët të lundrojnë në tendencat globale dhe të rrisin mirëkuptimin, gjë që është thelbësore në trajtimin e dallimeve në mënyrë konstruktive. Interesim merr edhe stabiliteti global, i cili po kalon një periudhë të tendosur konfliktesh. Bota po përballë me sfida të shumta, një marrëdhënie e fortë Kinë-BE mund të kontribuojë në paqen, stabilitetin dhe prosperitetin global dhe të garantojë sinjale pozitive për zgjidhje paqësore të çështjeve të nxehta dhe sensitive.

Më rëndësi mbetet bashkëpunimi teknologjik. Evropa mund të përfitojë nga gatishmëria e Kinës për ta konsideruar BE-në si një partner prioritar në bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik, i cili mund të nxisë inovacionin dhe zhvillimin.

Në një interes global të nxitur nga luajaliteti i këtyre marrëdhënieve

ekziston një mundësi për Evropën që të bëhet një partner i besueshëm në zinxhirët industrialë dhe të furnizimit, të cilat mund të rrisin sigurinë ekonomike dhe qëndrueshmërinë. Vizita mund të ndihmojë gjithashtu në adresimin e tensioneve tregtare dhe gjetjen e bazës së përbashkët për masat e sigurisë ekonomike që ndikojnë në marrëdhëniet tregtare dhe të investimeve me Kinën.

Sepse, siç na mëson Konfuci: “Lavdia jonë më e madhe nuk është të mos rrëzohemi kurrë, por të ngrihemi sa herë që biem.” Dhe është ky besim që ushqen me optimizëm këtë vizitë të presidentit kinez, Xi Jinping, vizitë e cila është një mundësi për Evropën që të angazhohet me Kinën në nivele të shumëfishta, nga politik në ekonomik, duke synuar forcimin e lidhjeve dhe përfitimet reciproke.

Vizita e liderit kinez Xi Jinping dhe nevoja për të nxitur marrëdhëniet tregtare me kontinentin evropian dhe Ballkanin Perëndimor



Nga Eteleva XHAJANKA

Presidenti kinez, Xi Jinping do të zhvillojë vizita shtetërore në Paris, Beograd dhe Budapest këtë javë, në përpjekje për të nxitur marrëdhëniet tregtare me kontinentin evropian.

Turi evropian i Presidentit Xi vjen në një moment kur Kina po i kushton vëmendje të lartë partneritetit me palën europiane dhe synon të thellojë bashkëpunimin e saj në Europë, duke përfshirë vendet ballkanike në fushën ekonomike, të mbrojtjes së mjedisit, të paqes etj.

